



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kmshc.al



www.kmshc.al

20 Tetor 2025

NJOFTIM

PËR PJESËMARRJEN E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL NË MBLEDHJEN E PËRBASHKËT TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE KOMISIONIT PËR NISMAT QYTETARE, BASHKËPUNIMIN DHE MBIKËQYRJEN INSTITUCIONALE

Më 20 tetor 2025, në ambientet e Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, në një mbledhje të përbashkët të Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale, Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Pranvera Strakosha, prezantoi raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit për vitin 2024.



Në fjalën e saj, znj. Strakosha bëri një përmbledhje të punës së zhvilluar gjatë vitit të kaluar, me fokus të veçantë në:

- zbatimin e rekomandimeve të miratuara nga Kuvendi në rezolutën e një viti më parë;
- procesin e mbikëqyrjes së shërbimit civil në institucionet e përfshira në këtë sistem;
- trajtimin e kërkesave dhe sinjalizimeve të ardhura nga nëpunës civilë dhe qytetarë;
- problematikat dhe sfidat që kanë shoqëruar funksionimin e sistemit gjatë vitit.

Në vijim, znj. Erjona Ismaili, në cilësinë e bashkërelatores së raportit, vlerësoi angazhimin e institucionit për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe përmirësimin e performancës në zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit.

Seanca dëgjimore u shoqërua me një diskutim aktiv nga ana e deputetëve, të cilët ngritën një sërë çështjesh me rëndësi, përfshirë: sfidat në procesin e rekrutimeve, nevojën për trajnime për nëpunësit civilë, zbatimin e vendimeve gjyqësore, si dhe adresimin e denoncimeve për përfshirje të administratës në fushatat zgjedhore.